



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.11.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Agim Gashi shef i GP të LDK –së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së.

Munguan: Mirlinda Sopi shefe e GP të AKR-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Besart Vllahinja, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Ferat Makolli drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Sami Boroci përfaqësues i AKR-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Shqyrtimi i raportit të tremujorit të tretë, korrik – shtator, për vitin 2016;**
- 3. Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;**
- 4. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – Qendrës së Arteve të Kosovës;**
- 5. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës – Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit;**

6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
8. Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve;
9. Miratimi i vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe;
10. Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës;
11. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja "Mati 1";
12. Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për një pjesë të lagjes "Dodona";
13. Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015 / 2016;
14. Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje;
15. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant;
16. Të ndryshme.

Për rendin e ditës diskutuan:

Agim Gashi kërkoi sqarime nga përfaqësuesi i Zyrës ligjore për pikën e dhjetë të rendit të ditës: Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës,

Lirak Çelaj propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës për Kuvend betimi i anëtarit të ri të Kuvendit, njëkohësisht propozoi për Kuvend ose në këtë mbledhje të diskutohet caktimi i zyrave për Ndërmarrjen "Parking".

Qëndron Kastrati, lidhur me rendin e ditës ngriti tri çështje:

E para, shprehi mbështetjen që për secilën pikë të rendit të ditës që kemi mungesë të materialit me kohë që ato pika të kthehen mbrapa qoftë për Kuvend apo për KPF.

Çështja e dytë është që këto pika të organizohen për dy mbledhje të rregullta të Kuvendit që mos të kemi kaq shumë pika për një mbledhje.

Çështja e tretë është se nuk ka nevojë të jetë në rend të ditës betimi i këshilltarit të ri se po i mohohet votimi i pikave deri në radhën që po i vjen.

Lirak Çelaj tha se e përkrahu propozimin që të ndahet material në dy pjesë se janë shumë pika. Njëkohësisht u interesua të dijë se lidhur me pikat e urbanizmit a ka pasur ndonjë koordinim me Ministrinë.

Hazir Borovci tha se pajtohem për pikat e rendit për të cilat nuk kemi material të mos diskutohet dh se materiali të ndahet për dy seanca të kuvendit se ka shumë pika.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me pikën e dhjetë - Propozimrregulloren për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, që e ngriti z. Agim Gashi.

Laura Zherka propozoi që për seancën e Kuvendit të shtohet edhe një pikë: Shqyrtimi i vazhdimit të vendimit për Qendrën e fëmijëve të udhëhequr nga Flora Brovina.

Halim Halimi, kryesues, tha nëse ekzekutivi ka përgatitur materialin mundem ta procedojmë më tutje.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, lidhur me propozimin e znj. Zherka, tha se nuk ka ardhur asnjë kërkesë specifike ku bëhet kërkesë për dhënien në shfrytëzim. Paraprakisht Qeveria duhet me adresua kërkesë kryetarit të Komunës i cili atë kërkesë e adreson në Kuvend Komunal, çka kjo nuk ka ndodhë deri tani pa ndodhë ky hap nuk mund të procedojmë më tutje.

Sa i përket caktimit të zyrave për Ndërmarrjen "Parking" kërkoi që aksionarët të adresojnë një kërkesë në ekzekutivë që kjo çështje të zgjidhet.

Qëndron Kastrati propozoi që këto pika të trajtohen këtu në komitet e mandej mi ndarë në dy seanca për Kuvend.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;

Dardan Sejdiu, nënkryetar kërkoi që ekstrakti të jetë në pika më të shkurta, mos të jetë si transkript.

Kryesuesi konstatoi se me vërejtjen e dhënë u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Shqyrtimi i raportit të tremujorit të tretë, korrik – shtator, për vitin 2016

Dardan Sejdiu, nënkryetar, në pika të shkurtëra i njoftoi të pranishmit për raportin e tremujorit të tretë për periudhën korrik- shtator 2016.

Agim Gashi bëri vërejtje në emërtimin e raportit duke cekur se është një shpërputhje në mes titullit të raporteve tre mujore, ku përmbajtja flet për nëntëmujor. Kërkoi që për mbledhje të Kuvendit të përmirësohet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Shqyrtimi i raportit të tremujorit të tretë, korrik – shtator, për vitin 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, mbetet të trajtohet në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financ.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Qendrës së Arteve të Kosovës

Agim Gashi tha se ka një mospërputhje në mes të rendit të ditës dhe materialit përkatës. **Ardian Olluri** dha sqarime duke cekur se në rendin e ditës është bërë një gabim teknik dhe se kjo do të rregullohet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Qendrës së Arteve të Kosovës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit

Halim Halimi, kryesues propozoi që në preambulë të hynë edhe propozimi i kryetarit të Komunës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Kuvendit të Motrave të Shën Kryqit dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë

Kryesuesi kërkoi nga Zyra ligjore që preambula e vendimit të korrigjohet dhe të përmissohet. Për këtë propozimvendim, **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, në pika të shkurtëra dha sqarime.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë që me plotësimin e propozuar për korrigjim i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)

Qëndron Kastrati tha se ne jemi kundër këtij propozimi, se nuk jemi mi dhënë një kompanie private pa kompenzim të një prone komunale.

Agim Gashi tha se nëse është fjala për vendosjen e një trafoje është mirë me ditë se a ka qenë kërkesë e lagjes aty ku instalohet, nëse po dhe banorët kanë investuar në objekt është mirë me votua, sa i përket kompanisë nuk jam që të votohet.

Dren Kukaj dha se është kërkesë e një banori të lagjes Mati 2, ku në pronën e tij është vendosur një trafo dhe sipas tij paraqet rrezik për qytetarë. Ne e kemi identifikua një parcelë komunale ku do ta vendoset trafoja dhe nuk do të paraqet problem për qytetarët. Kjo çështje është trajtuar edhe në nivelin qendror, ku sipas ligjit i mundësohet KEDS-it me pasur qasje pa kompensim në prona publike.

Dardan Sejdiu, nënkryetar kërkoj që rreth çështjes së kompenzimit nga Zyra ligjore ta kemi një informatë deri në mbledhjen e Kuvendit.

Lirak Çelaj tha se pajtohem që kompanitë private me pas kompensim, por në këtë rast është nevojë elementare e qytetarëve.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për Kompaninë kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) që Zyra ligjore deri në mbledhje të Kuvendit të sqarojë pozitat e ligjit dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve

Agim Gashi tha se ne në parim jemi mos ta ngarkojmë qytetin me objektet të përkohshme por të gjinden mënyra tjera si ti favorizojmë ata të cilët merren me këto veprimtari.

Qëndron Kastrati tha se shpërndarja e tyre a ka me shkuar përmes komisionit të caktuar nga komuna i zgjedhur prej Kuvendit dhe konsideroj se afati prej 15 vitesh për shfrytëzim mendoj se është i gjatë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar tha se logjika e këtij vendimi është ideja mi sistemuar qoshqet në vendet të cilat kanë kuptim urban dhe këto ekzistuese mu zëvendësuar me qoshqe të cilat në aspektin funksional e kryejnë punën, ku ne i kemi identifikuar 45 lokacione në komunën e

Prishtinës. Sa i përket billbordeve ne kemi bërë largimin e disave që kanë paraqitur rrezik për komunikacion dhe sinjalizim dhe përsëri numri është i madh mirëpo do të kërkoj prej drejtorisë së Inspektionit dhe Shërbimeve Publike që edhe një herë të rivlerësoj dhe të vij në Kuvend me një propozim si të riorganizohet puna e billbordeve.

Halim Halimi, kryesues kërkoi sqarime nga Zyra ligjore se a ka të drejt Komuna me dhënë leje për qoshqe në pronë shoqërore Drejtorisë së rrugëve të Kosovës ose hekurudhës. Lidhur me shqetësimin e ngritur nga kryesuesi rreth dhënies së qoshqeve në pronësi shoqërore, **Ardian Olluri** dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit për vendosjen e qoshqeve, dhe mbetet që për Kuvend Zyra ligjore të referon në bazë të ligjit dhe rregullores dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Miratimi i vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Miratimi i vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për taksën administrative për dhënien e lejes ndërtimore dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja "Mati 1";

Halim Halimi, kryesues tha se në mbledhjen e fundit të Kuvendit e kemi marrë një vendim që është miratuar, e kemi dërguar në MAPL për konfirmimin e ligjshmërisë dhe na është kthyer përgjigjja se jo vetëm kjo por të gjitha pikat e urbanizmit, si vendime të kundërligjshme.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se Ministria e ka obligim ligjor brenda 15 ditëve me kthye përgjigjen, mirëpo neve na është kthyer pas 35 ditëve dhe se sa i përket ekzekutivit janë të përmbushura të gjitha obligimet ligjore.

Agim Gashi tha se GP i LDK nuk do të marrë pjesë në votim në këto tri propozimvendime.

Qëndron Kastrati kërkoi që t'iu dërgohen të gjithë këshilltarëve konfirmimet e ligjshmërisë nga MAPI-ja, për aktet e komunës që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Lirak Çelaj kërkoi që krahas interpretimit të na sillen edhe vendimet siç janë hartuar, pasi janë dorëzuar në Ministri sepse kemi përshtypje se disa herë ka pasur shpërputhje të asaj që është dhënë dhe çka kemi votuar në asamble dhe asaj çka ka shkuar në Ministri .

Halim Halimi, kryesues tha se pajtohem që të jetë obligim i Shërbimit i Kuvendit që, sa herë i merre konfirmimet e vendimeve tona nga Ministria t'iu dërgohen asamblistëve si ato pozitive si negative në konsultim me drejtorin e Drejtorisë së Administratës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja "Mati 1" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për një pjesë të lagjes "Dodona";

Lirak Çelaj tha se më intereson se a është bërë ndonjë marrëveshje me banorët me atë plan dha a janë të kënaqur.

Genc Bashota drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dha sqarime.

Qëndron Kastrati tha se në Kuvend është diskutuar disa herë kjo pjesë dhe tash është zgjeruar edhe më shumë hapësira për të cilën po mendohet me u planifikua. Ka pasur vendim konsensual të Kuvendit ta realizoj atë pjesë ta bëjë park të qytetit. Nëse vendoset të bëhet ndërtim në i qëndrojmë prapa vendimit të më hershëm të Kuvendit dhe do të bëjmë çmos që atë hapësirë përpara ta bëjmë hapësirë gjelbëruese.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për një pjesë të lagjes "Dodona" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e trembëdhjetë

Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015 /2016;

Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, në pika të shkurtëra i njoftoi të pranishmit, Ajo ceku se në material është bërë një gabim teknik, ku në vend të fjalës raport duhet të jetë informatë.

Agim Gashi kërkoi që në të ardhmen informata të plotësohet me pasqyrën e të dhënave edhe nga shkollat private.

Arbërie Nagavci tha se sa i përket shkollave private nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e jona.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015 /2016 i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërmbëdhjetë

Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje;

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për fillimin e hartimin të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Lindje i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika pesëmbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant

Qëndron Kastrati tha se ne si grup kemi kërkuar që varrezat mos të ndahen në bazë të etnive por të shikohen mundësitë që varrezat të jenë si varreza të qytetit sipas lokacioneve të caktuara e jo të ndahen në bazë të religjionit.

Lirak Çelaj tha se është bërë një zgjidhje e mirë dhe se ata kanë kërkuar që në vendim të përfshihen edhe dy çështje mirëmbajtja nga Hortikultura dhe pyllëzimi aty afër.

Herën e kaluar e kemi marrë një vendim për një lokacion tjetër, a duhet mu shfuqizuar ai vendim paraprakisht për mu bërë ky tjetri. Për këtë kërkoj sqarim nga Zyra ligjore.

Halim Halimi, kryesues tha deri në Kuvend Zyra ligjore e gjen këtë vendim dhe ne e shfuqizojmë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Të ndryshme

U vendos që mbledhjet e Kuvendit të mbahen me datën 1 dhe 2 dhjetor.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.